



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA E TIRANËS  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2020

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Data: 08.06.2020

**Për: “Shpiragu” Sh.p.k, me adresë kryesore Rruga Dytësore Tiranë-Durrës, Km.5, Ndërtesa Polifunksionale ZDS, kati 0, Nr.Pasurie 8/30, Tiranë.**

Procedura e prokurimit: **Procedurë e Hapur**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **Blerje Materiale Pastrimi – REF-51437-02-24-2020.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Blerje Materiale Pastrimi – Fondi Limit 10 687 076,60 (dhjetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëdhjetë e gjashtë presje gjashtëdhjetë) lekë pa T.V.SH.**

**Artikujt dhe Sasitë e kërkuara:**

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>
1	Detergjent rrobash	kg	10,000
2	Solucion larës enësh-xhel	kg	6,000
3	Sfungjer enësh	copë	4,500
4	Tel enësh	copë	3,500
5	Qese mbeturinash plastmasi	pako	2,000
6	Peceta pastrimi	copë	2,800
7	Solucion ,zbardhues,dizifektues	litra	4,000
8	llaç xhamash (me sprucator)	litra	2,000
9	Solucion pllakash	litra	3,000
10	Doreza pastrimi	pale	2,000
11	Sapun rrobash	kg	800
12	Sapun tualeti	kg	900
13	Kova (me mekanizem shtrydhje)	copë	800
14	Fshesa me bisht	copë	1,000
15	Shtupa me bisht	copë	3,000
16	Solucion për pastrim sobave	kg	600

17	Solucion parketi	litra	2,500
18	Peceta duarsh (kartopeceta)	pako	42,000
19	Leter higjenike	pako	7,500

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike, **datë 02 Mars 2020, numër 8.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **“ANBIM” Sh.p.k** **L81618008J**  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*  
Vlera: 0 (zero) lekë pa T.V.SH.
2. **“Atlantik 3” Sh.p.k** **K22218003V**  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*  
Vlera : 8 770 000 (tetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë pa T.V.SH
3. **“Euro Mega 2010” Sh.p.k** **K91624505A**  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*  
Vlera : 8 045 000 (tetë milion e dyzetë e pesë mijë) lekë pa T.V.SH
4. **“Leon Group” Sh.p.k** **L51313013I**  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*  
Vlera : 8 902 500 (tetë milion e nëntëqind e dy mijë e pesëqind) lekë pa T.V.SH
5. **“Shpiragu” Sh.p.k** **J81503005U**  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*  
Vlera : 10 477 850 (dhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë pa T.V.SH

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **ANBIM Sh.p.k** **L81618008J**  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
2. **“Atlantik 3”** **K22218003V**  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
3. **“Euro Mega 2010”** **K91624505A**  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
4. **“Leon Group”** **L51313013I**  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

**1) “Anbim” Sh.p.k**

1.1. Operatori ekonomik ka paraqitur në sistem vetëm ekstraktin e regjistrimit në QKB

**2) “Atlantik 3” Sh.p.k**

2.1. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur mostra, në datën dhe orën e caktuar për hapjen e ofertave.

**Oferta ekonomike: 8 770 000 lek pa T.V.SH**

**3) “Euro Mega 2010” Sh.p.k**

3.1. Kriteret e veçanta pika 2.3.2, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion që vërteton disponimin e licensës me kod II.8.B.

3.2. Kriteret e veçanta pika 2.3.4.b, operatori ekonomik nuk ka paraqitur autorizimin e prodhuesit për sapunin e ngurtë me të dhënat e plota (tel, fax, web, e-mail).

3.3. Kriteret e veçanta pika 2.3.5, operatori ekonomik nuk ka paraqitur mostra sipas specifikimeve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor:

**3.3.1 Artikulli “Detergjentë larës rrobash”**

Mungon data e prodhimit dhe data e skadencës së produktit të paraqitur si mostër.

Konfeksioni i mostrës së analizuar është 2 kg dhe ndryshon nga konfeksioni i artikullit të paraqitur si mostër i cili është 3 kg.

Në Raport Analizën e paraqitur vërehet se ka ndryshime të rezultateve të treguesve të kërkuar, për disa prej tyre.

Komisioni ka konstatuar mangësi në produktin e paraqitur si mostër dhe dokumentacionin e saj shoqërues:

- Në produktin e paraqitur si mostër, mungon data e skadencës dhe e prodhimit.
- Nga të gjithë treguesit e analizuar në Raport Analizën e paraqitur, pjesa më e madhe e tyre nuk plotësojnë parametrat e kërkuar në specifikimet teknike:

I. Përmbajtja e lagështisë është 4.9%, nga  $\leq 1.5\%$  që kërkohet në specifikimet teknike. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive është 6.1%, nga 10-15% që kërkohet në specifikimet teknike. Përmbajtja e perboratit të natriumit është 4.8%, nga 10-11 % që kërkohet në specifikimet teknike.

Nga verifikimi i të dhënave të produktit të paraqitur si mostër dhe treguesit e analizuar, Komisioni i Verifikimit dhe Inspektimit të Mostrave vendosi që mostra e paraqitur nuk i plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

### **3.3.2 Artikulli “Solucion larës enësh”**

Mungon data e prodhimit dhe data e skadencës së produktit të paraqitur si mostër.

Në Raport Analizën e paraqitur vërehet se ka ndryshime në raport me treguesit e kërkuar, për disa tregues.

Komisioni ka konstatuar mangësi në produktin e paraqitur si mostër dhe dokumentacionin e saj shoqërues:

- Në produktin e paraqitur si mostër, mungon data e skadencës dhe e prodhimit.
- Nga treguesit e analizuar në Raport Analizën e paraqitur, treguesi Përmbajtja e lëndëve tensioaktive është 5.64%, nga 32-35% që kërkohet në specifikimet teknike.

Nga verifikimi i të dhënave të produktit të paraqitur si mostër dhe treguesit e analizuar, Komisioni i Verifikimit dhe Inspektimit të Mostrave vendosi që mostra e paraqitur nuk i plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

### **3.3.3 Artikulli “Peceta pastrimi”**

Përmasat e mostrës së paraqitur janë 35x38 cm, në ndryshim nga përmasat e kërkuara në specifikimet teknike, ku kërkohen përmasat 38x40 cm.

Mostra e paraqitur nuk i plotëson specifikimet teknike të kërkuara.

### **3.3.4 Artikulli “Sapun rrobash”**

Konstatohet se OE nuk ka paraqitur Raport Analizë apo skedë teknike për këtë produkt.

Komisioni i Verifikimit dhe Inspektimit të Mostrave vendosi që mostra e paraqitur nuk i plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

### **3.3.5 Artikulli “Sapun tualeti”**

Në Raport Analizën e paraqitur me nr. D-09, datë 29.01.2020, rezulton se nuk përcaktohet emërtimi i markës tregëtare të produktit të analizuar.

Për këtë produkt OE ka paraqitur skedën teknike me emërtimin “Sapun duarsh”. Skeda teknike e paraqitur është lëshuar nga subjekti “Anhel” shpk, ndërkohë që mostra e paraqitur është prodhuar nga prodhuesi “Tat Kimya Sabun ve Gliserin Sanayii ve Ticaret” a.s Turqi.

Për arsyen se nga verifikimi i artikullit të paraqitur si mostër dhe dokumentacionit shoqërues, komisioni nuk arrin të kyejë lidhjen midis produktit të paraqitur si mostër dhe Raport Analizës dhe Skedës teknike të paraqitur, Komisioni i Verifikimit dhe Inspektimit të Mostrave vendosi që mostra e paraqitur nuk i plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

### **3.3.6 Artikulli “Shtupa me bisht për larje dysHEMEJE”**

Gjatësia e fijeve të pambukut të shtupës është 26.5 cm në ndryshim nga përmasat e kërkuara në specifikimet teknike ku kërkohet që gjatësia e fijeve të pambukut të shtupës të jetë 32 cm.

Komisioni i Verifikimit dhe Inspektimit të Mostrave vendosi që mostra e paraqitur nuk i plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

### **3.3.7 Artikulli “Solucion parketi”**

OE deklaroi se në sistemin elektronik, ka paraqitur Raport Analizën dhe Skedën teknike të produktit.

Pas verifikimit në sistemin elektronik, konstatohet se OE nuk ka paraqitur Raport Analizë për këtë produkt.

Për këtë produkt OE ka paraqitur në sistemin elektronik skedën teknike të sigurisë për këtë produkt, me emërtimin: “Solucion për parket”.

Për arsye se OE nuk ka paraqitur Raport Analizë për këtë produkt, sikurse kërkohet në dokumentet e tenderit, Komisioni i Verifikimit dhe Inspektimit të Mostrave vendosi që mostra e paraqitur nuk i plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

### **3.3.8 Artikulli: “Peceta duarsh (kartopeceta)”**

Në të dhënat e përshkruara në ambalazhin e produktit të paraqitur si mostër, nuk përshkruhet pesha specifike e pakos, sikurse kërkohet në specifikimet teknike, e cila duhet të jetë 130-150 gr. Referuar të dhënave të përshkruara në ambalazhin e produktit të paraqitur si mostër, paketimi përmban 55 fije peceta, dhe jo sipas specifikimeve teknike të përcaktuara, ku kërkohet që numri i fijeve të jetë “70 fije peceta për 1 pako”.

Komisioni i Verifikimit dhe Inspektimit të Mostrave vendosi që mostra e paraqitur nuk i plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

### **3.3.9 Artikulli: “Letër higjenike”**

Numri i shtresave të letrës është 2 dhe jo sipas specifikimeve teknike të përcaktuara ku kërkohet që numri i shtresave të jetë 3-4.

Në ambalazhin e mostrës së paraqitur nuk gjendet informacion mbi numrin e nën-ndarjeve të vogla për çdo rulon dhe përmasat e tyre, sikurse kërkohet në specifikimet teknike që çdo rulon duhet të jetë i ndarë në jo më pak se 130 -150 nën-ndarje të vogla me përmasa: gjerësia e nën-ndarjes jo më pak se 9-10 cm, gjatësia e nën-ndarjes jo më pak se 11-12 cm.

Në ambalazhin e mostrës së paraqitur nuk gjendet informacion mbi peshën specifike të një ruloni, sikurse kërkohet në specifikimet teknike ku kërkohet që: Pesha specifike e një ruloni të jetë 100-150 gr.

Komisioni i Verifikimit dhe Inspektimit të Mostrave ka peshuar mostrën e paraqitur nga ku rezultoi që pesha një ruloni është 50 gr, e cila nuk është në parametrat e kërkuar në specifikimet teknike.

Komisioni i Verifikimit dhe Inspektimit të Mostrave vendosi që mostra e paraqitur nuk i plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

**Oferta ekonomike: 8 045 000 lekë pa T.V.SH**

**4) “Leon Group” Sh.p.k**

- 4.1. Kriteret e veçanta pika 2.3.1, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion që përmbush 40% e kontratave/faturave të ngjashme. Vlera e faturave tatiore të paraqitura nuk e arrin vlerën prej 40% të fondit limit, ndërsa kontrata me institucion publik nuk është shoqëruar me vërtetim realizimi, sikundër kërkohet në DST.
- 4.2. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur mostra, në datën dhe orën e caktuar për hapjen e ofertave.

**Oferta ekonomike: 8 902 500 lekë pa T.V.SH**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik “Shpiragu” sh.p.k, me adresë Rruga Dytesore Tirane-Durres, Km.5, Ndertesa Polifunkionale ZDS, kati 0, Nr.Pasurie 8/30, Tiranë** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **10 477 850 (dhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë)** lekë pa T.V.SH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve** me adresë Rr. “ Barrikadave ”, Çerdhja Nr. 1, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar), siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në **28.05.2020**.

Ankesa: Nuk ka patur ankesa.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Zhaneta BEQIRI**